



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
 AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

**PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011**

**S E S I O N I II**

**(I DETYRUAR)**

**VARIANTI A**

E premte, 9 shtator 2011

Ora 10.00

**Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe**  
**Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja**

**Udhëzime për nxënësin**

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dyja pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

**Për përdorim nga komisioni i vlerësimit**

<b>Kërkesa</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9a</b>	<b>9b</b>	<b>10a</b>	<b>10b</b>
<b>Pikët</b>												
<b>Kërkesa</b>	<b>11A</b>	<b>11B</b>	<b>12</b>	<b>13a</b>	<b>13b</b>	<b>13c</b>	<b>13d</b>	<b>14</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>17</b>	<b>18</b>
<b>Pikët</b>												
<b>Kërkesa</b>	<b>19</b>	<b>20</b>	<b>21a</b>	<b>21b</b>	<b>22A</b>	<b>22B</b>	<b>23</b>	<b>24</b>	<b>25a</b>	<b>25b</b>		
<b>Pikët</b>												

**Totali i pikëve**

**KOMISIONI I VLERËSIMIT**

1.....Anëtar

2.....Anëtar

**PJESA I****NDRE MJEDA****ANDRRA E JETËS (*Fragment*)****LOKJA**

E n' balkue mbaruene lulet:  
Shurdh a vendi<sup>1</sup> e shpia tytë<sup>2</sup>,  
Jo, me Lokën një e dytë  
Nëpër shpi ma nuk u gjet.

Vetun zbardh e vetun erret  
Me kry n'hi e shuemja plakë;  
Nji dorë krande me i ba flakë  
Përmbi vatër kush s'ia qet.

E disprohet me vetvedi  
Që nuk bani kurrë një djalë:  
Sot e reja<sup>3</sup> i kish dalë  
Bashkë me dritë për dru në shpat.

Kish mbajtë zjerrmin ndezë mbi votër,  
Ia kish njomë njat buk<sup>4</sup> e mjera;  
Edhe Lokja me gjith' tjera  
Kishte dalë me petka<sup>4</sup> n' shtat<sup>5</sup>.

Kish shkue motin si predevra  
Me ndo'j fëmi tu' e kalamendun<sup>7</sup>;  
Ishte knaqë tuj e përmendun<sup>8</sup>  
Tash e tash ferishta n' djep.

E disprohet ke i ve mendja  
Or' e ças te Trina, e shkreta!  
Ia lyp mordës n' ankime t' veta,  
Por mizorja nuk ia nep.

**Fjalor**

1. *shurdhë vendi* – vetmi e plotë
2. *tytë* – e zbrazët, boshe
3. *e reja* – nusja
4. *petka* – rroba
5. *n' shtat* - në trup
6. *bashkë me dritë* – në agim
7. *me kalamendun* – përkund kot, vë për të fjetur
8. *me përmendun* – thërres, zgjoj prej kujtimeve

Për pyetjet 1-6 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Personazhi qendror në poemën “*Andrra e jetës*” është: **1 pikë**
- A) Tringa  
B) Zoga  
C) Lokja  
D) bashkëshorti i saj.
2. Në këtë fragment Lokja e qorton veten: **1 pikë**
- A) për vdekjen e Tringës.  
B) për moslindjen e një djali.  
C) për ikjen e të dy vajzave.  
D) për shtëpinë që po i shembet.
3. Cila është figura mbi të cilën ngrihet gjendja psikologjike dhe fizike e Lokes? **1 pikë**
- A) Alegoria  
B) Simboli  
C) Krahasimi  
D) Paralelizmi figurativ
4. Në këtë këngë autori priret të na tregojë: **1 pikë**
- A) vetminë e pangushëlluar të një gruaje.  
B) shkatërrimin që vjen pas vdekjes.  
C) vazhdimësinë e pandalshme të jetës.  
D) vetminë dhe ftohtësinë që shkakton stina e dimrit.
5. Në cilin prej vargjeve është pikërisht grupi i foljeve që jep idenë e një kohe që shkon në vetmi të plotë? **1 pikë**
- A) Ishte knaqë tuj e përmendun.  
B) E disprohet ke i ve mendja.  
C) Kish mbajtë zjerrmin ndezë mbi votër.  
D) Vetun zbardh e vetun erret.
6. Kjo pjesë është shkruar me varg: **1 pikë**
- A) 7- rrokësh  
B) 8- rrokësh  
C) 9- rrokësh  
D) 10 rrokësh
7. Përshkruani me pak fjalë atmosferën që mbizotëron në këtë fragment. Cili është funksioni artistik i një zgjedhjeje të tillë nga ana e autorit? **2 pikë**
- 
- 

8. Çfarë i kërkon Lokja vdekjes? Pse pikërisht në këtë moment? **2 pikë**
- 
-

9. Në vargun “*Kish mbajtë zjerrmin ndezë mbi votër*”, fjala “*zjarrm*” mund të interpretohet në kuptim të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm. Si e shpjgoni secilin prej tyre?

a) i drejtpërdrejtë: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) i figurshëm: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

10. Cili është ritmi i këtij fragmenti? Shpjegoni arsyen e kësaj zgjedhjeje nga ana e autorit.

a) ritmi: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) shpjegimi: \_\_\_\_\_ **1 pikë**

11.

A) Ç’ndjesi ju sugjerojnë epitetet *shurdh e tytë* në vargun *Shurdh a vendi e shpia tytë*? Me ç’pjesë të ligjëratës janë shprehur ato? **2 pikë**

a) ndjesia: \_\_\_\_\_

b) pjesa e ligjëratës: \_\_\_\_\_

B) Gjeni një sinonim për fjalën *e shuemja*. Ç’ngarkesë emocionale mbart kjo zgjedhje e bërë nga autori? **2 pikë**  
*Me kry n’hi e shuemja plakë*

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

12. Strofat 3, 4, dhe 5 krijojnë kontrast me strofat e tjera të këtij fragmenti. Shpjegojeni këtë duke e ilustruar mendimin tuaj edhe me disa nga shprehjet ose fjalët kyç që japin thelbin e këtij kontrasti. **3 pikë**

---



---



---

13. Për shumë njerëz jeta mbetet një ëndërr. A jeni dakord me këtë pohim? Argumentoni mendimin tuaj duke u mbështetur edhe në poemën “*Andrra e jetës*”. **8 pikë**

Shtjellimi i idesë	Organizimi dhe struktura	Stili dhe originaliteti	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi)	Totali
(13a)	(13b)	(13c)	(13d)	13
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë

**PJESA II****Viktor Hygo****Katedralja e Parisit (*Fragment*)**

Papritmas, në çastin kur ndihmësit e xhelatit do të zbatonin urdhrin e dhënë me gjakftohtësi, ai njeri kapërceu parmakun e galerisë dhe e kapi tërkuzën me këmbë, me gjunjë dhe me duar; pastaj rrëshqiti tatëpjetë fasadës së katedrales, si ajo pika e shiut që shket tatëpjetë një xhami, rendi te të dy ndihmësit e xhelatit me shkathtësinë e një maceje që bie nga çatia, i rrëzoi ata përdhe me të dy grushtet e tij të fuqishëm, rrëmbeu me njëren dorë ciganen, siç rrëmben një fëmijë kukullën, dhe, pasi e ngriti vajzën përmbi kokën e tij, u sul në kishë, duke sokëllitur me një zë buçitës:

- Strehim!

Kjo u bë me që shpejtësi, saqë, po të kishte ndodhur natën, të pranishmit mund ta kishin parë këtë skenë nën dritën e një vetëtime të vetme.

Kjo ngjarje e papritur e bëri të dënuarën të vinte në vete. Ajo hapi qepallat, vështroi Kuazimodon dhe i mylli shpejt përsëri, si e trembur nga shpëtimtari i saj.

Sharmolyu, xhelatët dhe gjithë rojtarët shtangën në vend. Brenda mureve të katedrales së Shën Mërisë e dënuara ishte me të vërtetë e paprekshme. Katedralja ishte një strehë e sigurt dhe te pragu i saj pritej hovi i drejtësisë njerëzore.

Kuazimodo ishte ndalur tani nën kubënë e portalit të madh. Shputat e gjera të këmbëve të tij dukej se shkelnin aq fort mbi plloçat e gurta të dyshemesë, sa dhe shtyllat e rënda romanike. Koka e tij e madhe dhe leshatake humbte midis supeve, si koka e një luani, që ka dhe ai një krifë të gjatë, e cila i mbulon qafën. Ai po e mbante vajzën e tmerruar mbi pëllëmbët e duarve të tij të vrazhda, si ndonjë copë pëlhurë të bardhë; por e mbante me aq kujdes, saqë dukej sikur kishte frikë se mos e copëtonte ose mos e prishte. Do të thoshte se Kuazimodo e ndiente që ajo ishte diçka e brishtë, elegante dhe e çmueshme, diçka jo e krijuar për duart e tij të ashpra. Herë – herë dukej se ai nuk guxonte ta prekte atë as me frymën e tij. Pastaj, befas, e shtrëngonte në krahët e tij, në gjoksin e tij çipa – çipa, si të ishte plaçka e tij, thesari i tij. Kështu e shtrëngon nëna në gjë fëmijën e vet. Syri i tij prej ciklopi ulje herë – herë mbi vajzën dhe i shprehte kësaj butësi, ëmbëlsi, dhembshuri, por pastaj ngrihej prapë lart, duke lëshuar shkrepitima. Atëherë gratë qeshnin e qanin, turma brohoriste nga entuziazmi, sepse në ato çaste Kuazimodo ishte vërtetë i bukur. Po, ishte i bukur ky jetim, ky fëmijë i gjetur, ky njeri i neveritur; dhe ai e ndiente veten të fortë e të madhërishtë dhe po e vështronte drejt në sy atë shoqëri, që e kishte dëbuar, por në punët e së cilës ai ndërhynte kaq fuqimisht; e vështronte drejt në sy atë drejtësi njerëzore, së cilës ai i kishte rrëmbyer prenë, gjithë ata tigra, që i kishte lënë me gisht në gojë, ata rojtarë, ata gjyqtarë, ata xhelatë, tërë atë forcë të mbretit, që ai njeri aq i parëndësishëm e kishte thyer.

E pastaj ishte një gjë aq prekëse ajo ndihmë e dhënë nga një qenie e shëmtuar si Kuazimodo, një qenieje fatkeqe, që ishte dënuar me vdekje. Kuazimodo dhe Esmeralda ishin dy njerëz të përbuzur nga natyra dhe shoqëria; ata ndodheshin në të njëjtën shkallë mjerimi dhe tani po ndihmonin njëri-tjetrin.

E turma duartrokiste. Më së fundi, ai u duk për të tretën herë në majë të kullës së kabanës së madhe dhe prej andej i tregoi me krenari tërë Parisit vajzën që kishte shpëtuar. Me një zë si bubullime, që njerëzit vetëm rrallë herë e dëgjonin dhe që ai vetë nuk e dëgjonte kurrë, sokëlliu tri herë me furi deri lart te retë:

- Strehim! Strehim! Strehim!

Për pyetjet 14-20 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

14. Situata që përshkruhet në këtë fragment është: **1 pikë**
- A) absurde
  - B) komike
  - C) tragjike
  - D) e jashtëzakonshme
15. E veçanta e stilit të autorit në paraqitjen e atmosferës në këtë fragment shfaqet në: **1 pikë**
- A) kontrastin artistik.
  - B) përshkrimin e mjedisit.
  - C) përshkrimin e personazheve.
  - D) dialogun midis personazheve.
16. Në cilën prej alternativave të mëposhtme shprehet ideja e kësaj pjese? **1 pikë**
- A) Qeniet e shëmtuara mbeten të përbuzura.
  - B) Është e lehtë të nënshtrosh të pambrojturit.
  - C) Mirësia i bën njerëzit më të ndjeshëm.
  - D) Edhe të përbuzurit mund ta sfidojnë shoqërinë.
17. Ajo që e bashkon Esmeraldën me Kuazimodon është se të dy: **1 pikë**
- A) akuzohen për vrasje.
  - B) janë dëbuar nga shoqëria.
  - C) janë dënuar me vdekje.
  - D) janë mallkuar nga kisha.
18. Për të dhënë gjendjen emocionale të Kuazimodos autori përdor një numër të madh: **1 pikë**
- A) mbiemrash
  - B) emrash
  - C) foljesh
  - D) përemrash
19. Në fjalinë *sokëlliu tri herë me furi deri lart te retë* fjala “*sokëlliu*” ka kuptimin: **1 pikë**
- A) bërtiti
  - B) shau
  - C) pëshpëriti
  - D) u kollit
20. Cili nga çiftet e mëposhtme krijon antonimi kontekstuale? **1 pikë**
- A) ky fëmijë i gjetur - ky njeri i neveritur.
  - B) qenie e shëmtuar – qenie fatkeqe.
  - C) diçka e brishtë – duart e ashpra.
  - D) gratë qeshnin – turma brohoriste.

21.

- a) Kuazimodo e strehon Esmeraldën në katedrale. Pse drejtësia njerëzore nuk mund të vepronte aty? **1 pikë**

---

- b) Çfarë kanë të përbashkët Kuazimodo dhe Esmeralda? Në ç' mënyrë ata po i vinë në ndihmë njëri--tjetrit? **3 pikë**

---



---

22.

- A) Cila është figura e stilistikës në fjalinë: *Syri i tij....duke lëshuar shkrepitima.*? Zbërtheni nëntekstin e këtij përdorimi. **2 pikë**

a) Figura e stilistikës: \_\_\_\_\_

b) Nënteksti: \_\_\_\_\_

- B) Gjeneri në fragmentin e dhënë një mbiemër që thekson **gjendjen shpirtërore** dhe një tjetër që thekson **pamjen e jashtme** të Kuazimodos. **2 pikë**

a) gjendja shpirtërore: \_\_\_\_\_

b) pamja e jashtme: \_\_\_\_\_

23. E gjithë figura e Kuazimodos ngrihet në këtë fragment mbi bazën e kontrastit. Shpjegojeni këtë duke dhënë edhe një ilustrim nga pjesa. **2 pikë**

---



---

24. Ku qëndron sfida më e madhe e Kuazimodos? Mbi çfarë po triumfon ai? **2 pikë**

---



---

25. Zbuloni në fragmentin e dhënë dy karakteristika të romantizmit bashkë me ilustrimet përkatëse.

a) \_\_\_\_\_ **1 pikë**

b) \_\_\_\_\_ **1 pikë**